

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësive e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, të cilët, me veprime apo mos veprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorruption, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Gusht, 2022

Shpallet për konsultim publik drafti i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2023 - 2030

DOKUMENTI KONCEPTUAL STRATEGJIK	
Titulli i propozimit	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2023-2030
Institucioni udhëheqës	Ministria e Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit
Personi i kontaktit	Zoi Adn Prati, Zvendeshtues i Drejtësisë Zoi Lumbëris Masi, Deputet, Drejtoria e Programeve dhe Projekteve AK
Vizioni i Programit për Sektorin	Institucione publike që funksionojnë në përputhje me standartet në të lartë të integritetit, transparencës dhe ligjërdësisë publike dhe ofrojnë shërbime që janë ndërkombëtare.
Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit (SNKK), 2015-2020 e cilët kufizojnë e që çelë si zgjidhje për zbatimin në vitin 2022, si dhe plani i veprimit në vitet 2020-2022, do të përfundojnë në vitin e ardhshëm SNKK dhe dokument kryesor që përcakton politikën dhe programin strategjik antikorruption të Shqipërisë dhe drejton veprimin antikorruption në nivel kombëtar. Që nga miratimi i SNKK në vitin 2015, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash që synojnë rritjen e përgjigjësisë dhe kapaciteteve të vendit për të parandaluar, fëmur e reduktuar korrupsionin. Në numër i madh i lartë reformave janë zbatuar deri tashmë dhe kanë dhënë rezultate në kundërt zbatimit të SNKK dhe shprehur në të njëjtën mënyrë.	

15-26.08.2022: Ministria e Drejtësisë vijon punën për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023 – 2030. Gjatë muajit gusht, janë zhvilluar takime të dedikuara me secilin institucion përgjegjës, në mënyrë që të dakordësohet përmbajtja e pasaportës së indikatorëve që do të shoqërojnë dokumentin strategjik, vlerat e tyre të arritjes (*targets*) përgjatë çdo viti të zbatimit të saj. Draft pasporta e indikatorëve përmban 41 indikatorë, nga të cilët, 15 i përkasin fushës së përgjegjësisë shtetërore të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, e pjesa tjetër ndiqen nga institucionet e tjera përgjegjëse. Në vijim, po punohet për të hartuar dhe konceptuar Planin e Veprimit, që do të materializojë në produkte konkrete objektivat e vendosur në strategji. Grupi institucional i punës i Ministrisë së Drejtësisë, asistohet ngushtësisht në këtë proces nga Projekti i Asistencës Teknike të Delegacionit të Bashkimit Europian.

Draft koncept dokumentin e Strategjisë Antikorruption 2023-2030, mund ta gjeni të publikuar në linkun: <https://www.drejtësia.gov.al/sstrategjia-ndersektoriale-kunder-korrupsionit/>

Hartohet Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antikorruption, janar-qershor 2022

24.08.2022: Sekretariati teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, ka hartuar draftin e raportit të monitorimit për periudhën janar - qershor 2022, të strategjisë në zbatim antikorruption, 2015-2023. Drafti i parë i monitorimit, jep një informacion vlerësues mbi ecurinë e 18 objektivave specifike për të tre qasjet e politikave të parandalimit – ndëshkimit - ndërgjegjësimi kundër korrupsionit si dhe gjithashtu paraqet vlerësimin 6-mujor për treguesit e performancës duke pasqyruar të dhënat e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara. Në 6-mujorin e parë 2022, rezultojnë se nga totali prej 56 masash e 103 aktiviteteve të parashikuara për zbatim, janë realizuar 37 masa e 65 aktivitete, janë në proces zbatimi 12 masa e 8 aktivitete, e ngelen të pazbatuara 7 masa e 30 aktivitete. Drafti i raportit të monitorimit është dërguar për konsultim të brendshëm me të gjitha institucionet kontribuese, për plotësim. Në vijim ky raport do të diskutohet dhe miratohet në takimin e Komitetit Koordinator Kundër Korrupsionit.

Draftin e parë të këtij raporti monitorimi mund ta gjeni të publikuar në <https://drejtësia.gov.al/viti-2022-2/>

Qasja (Qëllimet e Politikës)	Masa dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitetet të parashikuara për periudhën janar - qershor 2022	Masa dhe aktivitetet plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitetet pjesërisht të realizuara ¹⁾	Masa dhe aktivitetet të paralizuar ²⁾
Parandaluese	Masa	30	19	8	3
	Aktivitetet	58	38	5	15
Ndërkohëse	Masa	18	11	4	3
	Aktivitetet	28	16	3	9
Ndërgjegjëse	Masa	8	7	0	1
	Aktivitetet	17	11	0	6
Total	Masa	56	37	12	7
	Aktivitetet	103	65	8	30

Hartohen raportet 6 mujore të monitorimit të zbatimit të Planeve të Integritetit në varësitë e Ministrisë së Drejtësisë

Drejtorja e Programeve dhe Projekteve Antikorruption ka vijuar punën dhe angazhimin direkt mbi ngritjen dhe zbatimin e instrumenteve të luftës së korrupsionit në administratën publike përmes Planeve të Integritetit. Gjatë muajit gusht, institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, kanë filluar procesin për monitorimin e zbatimit dhe hartimin e raporteve të Planeve të Integritetit. Të gjitha këto institucione janë asistuar teknikisht nga Ministria e Drejtësisë. Raportet e monitorimit të Planeve të Integritetit të institucioneve të varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, do të përfundojnë së hartuari dhe do të publikohen brenda muajit shtator 2022.

PLANI I INTEGRITETIT

PËR MINISTRINË E DREJTËSISË

2020-2023

Komponenti Antikorrupsion rol thelbësor në prezantimet “Screening” në Bashkimin Evropian

Në kuadër të procesit Screening, angazhimi Qeverisë Shqiptarë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, institucionet publike shqiptare janë angazhuar në një raund prezantimesh simuluese, me qëllim që të unifikohet dhe përsoset formati final i tyre, një ushtrim simulues në funksion të prezantimeve teknike që do të zhvillohen në Bruksel për kapitullin 23 dhe 24. Prezantimi i komponentit antikorrupsion do të udhëhiqet nga Ministria e Drejtësisë në ushtrim të rolit të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit. Prezantimi i Ministrisë së Drejtësisë përmban një përmbledhje të kuadrit legjislativ të brendshëm të fushës antikorrupsion, atij ndërkombëtar dhe nivelin e përafrit në kuadrin kombëtar. Komponenti antikorrupsion përmban gjithashtu një vështrim të përgjithshëm të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015 – 2023, hartimi i strategjisë së re 2023 – 2030, përshkrim të detajuar të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion dhe të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të dhëna statistikore, përditësime lidhur me procesin e Planeve të Integritetit si dhe raportin e vetëvlersimit në kuadër të 24 rekomandimeve të GRECO V. Me qëllim trajtimin e një kuadri sa më gjithëpërfshirës, komponenti antikorrupsion përmban edhe të dhëna të institucioneve partnere në luftën kundër korrupsionit, si Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Policia e Shtetit, ILDKPKI dhe AAPSK. Këto të dhëna do të shërbejnë për të plotësuar pasqyrimin e plotë të qasjes parandaluese, në luftën kundër korrupsionit.



REPUBLIC OF ALBANIA

Negotiating Team for the Accession of Albania to the European Union

Bilateral Screening: Chapter XX
PRESENTATION OF ALBANIA